

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 18.04.2023*

18.04.2023
Ora 14:30

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në Vendet e Numërimit të Votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.


PJESËMARRJA:

- **KQZ:**
- **Komisioni Rregullator:**
 - Ilirjana NANO** **Kryetare**
 - Arens ÇELA** **Anëtar**
 - Dritan ÇAKA** **Anëtar**
 - Helga VUKAJ** **Anëtare**
 - Muharrem ÇAKAJ** **Anëtar**
- **Stafi i KQZ-së:** **Y. Merkaj**
- **Parti Politike:** **PDIU**
- **OJQ:** **KRIIK**

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme ora 14:30. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, sekretari i përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfaqësues të subjekteve zgjedhore. Në rendin e ditës në mbledhjen e sotme kemi dy projektvendime, e para “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes

1

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 18.04.2023*

vendore të datës 14 maj 2023”. Projektvendimi i dytë “Për përdorimin e pajisjes të indentifikimit elektronik të votuesve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Para se të fillojmë me shqyrtimin e dy projektvendimeve që kemi në rendin e ditës do të pyesja kolegët: Nëse ka diçka jashtë rendit të ditës që duan ta diskutojnë? Nuk ka, fillojmë me rendin e ditës. Të dy projektvendimet kanë ardhur si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Do të ftoja Sekretarin e Përgjithshëm, të nisë me prezantimin e projektvendimit të parë për përdorimin e kamerave regjistruese dhe monitorëve, zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Bazuar në nenin 20, pika 2, shkronja “c” e Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin projektaktve me karakter normativ të përgatituara nga administrata e KQZ-së, ose nga antarët e tij për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë informacionit për mbulimin e e aspekteve apo procedurave te veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi. Referuar dispozitës së mësipërme kemi përgatitur projektvendimin “Për përdorimin e kamerave të regjistrimit dhe monitorimit për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Projektvendimi ka për qëllim vendosjen dhe përdorimin e kamerave regjistruse në vendet e numërimit të votave për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Gjithashtu referuar dhe nenit 22, pika 2, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kompetencë të instalojë dhe përdorë sistemin video-monitorimi në qendrat e votimit si dhe ku bëhet numërimi manual i votave në vendin e numërimit të votave për të monitoruar dhe provuar rregullshmërinë e procesit në mjediset e brendëshme të tyre. Referuar nenit 94, pika 4, të Kodit Zgjedhor, përdorimi i kamerave

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 18.04.2023**

regjistruese dhe të monitoruese dhe për shfaqjen e fletëve të votimit për të parë vlerësimet e tyre, vendos KQZ-ja për përdorimin e këtyre kamerave. Kamerat me rezolucion të lartë, instalohen në tavolinat e numërimit në mënyrë të tillë që të bëjnë të mundur regjistrimin dhe vlerësimin e çdo flete votimi. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit, zoti Merkaj! Fillojmë shqyrtimin në parim të projektvendimit. Kolegë kemi diçka në parim? Nëse jo kalojmë në votimin në parim të projektvendimit, ndërkohë dhe nga përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore dhe nga organizata e shoqërisë civile nuk ka gjë në parim për të. Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka


Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në shqyrtimin nën për nën ose pikë për pikë. Vendimi ka 5 pika. Po zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Vë re, tek relacioni që sapo e shpalosi zoti sekretar përgjithshëm, që kemi një fragment aty diku në fund të faqes së parë, që thuhet nëse nuk e kryen vetë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtë të prokurojë instalimin ose dhe operimin e sistemit të video-monitorimit. Ky nuk është një akt që kërkon këto lloj normative sepse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i di vetë të drejtat që ka mbi pajisjet dhe detyrimet apo përgjegjësitë që i lindin nga akte të tjera. Ky është një akt që kërkon thjesht një raportim për aq sa i përket përmbajtjes së propozuar dhe

3

**Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 18.04.2023*

nuk duhet të ishte pjesë e propozimit, mendoj. Kështu që e konsideroj se është e tepërt, në zbardhje mendoj që të mos jetë.

Znj. I. Nano: Dakord, në respekt të kësaj që sapo trajtoi zonja Vukaj, do të luteshim që dokumentacioni që përmban dosjen e plotë të projektvendimit me gjithë relacionin të reflektojë dhe këtë shqetësim. Fillojmë me shqyrtimin nen për nen, pikë për pikë.

Pika e parë, atëhere Komisioni Rregullator vendosi:

1. Përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve ekraneve për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit në vend të numërimit të votave në zgjedhjet për organet e “qeverisjes vendore” të datës 14 maj 2023.

Znj. H. Vukaj: Mendoj mos ta lëmë kështu përgjithësuese, vendet e numërimit të votave por do të ishte më korrekte nëse do të shtonim fjalën “çdo” përpara vendeve të numërimit të votave. Në të tre pikat e projektit të ardhur.

Znj. I. Nano: Atëherë, e votojmë këtë propozim dhe më tej nëse votohet të reflektohet edhe me të tjerat. Atëherë po e rilevoj. Përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve, ekraneve për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit në çdo vend të numërimit të votave në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 18.04.2023*

Me 5 vota pro miratohet!

Në pika të tjera përmendet vendet e numërimit të votave unë do ta lexoj si kundër sapo e miratuam.

Znj. I. Nano: Pika 2, përdorimin e sistemit të transmetimit video në kohë reale të monitorimit të numërimit të votave nga çdo vend i numërimit të votave në ambjentet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Pika 3. Përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve, ekraneve dhe sistemit të transmetimit në kohë reale nga çdo vend i numërimit të votave, në ambjentet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të bëhet në bazë të rregullave procedurale të miratuara me akt normativ nga Komisioni Rregullator.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 18.04.2023*

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet

Para pikës 5, ajo pika që kemi thënë në çdo rast i ngarkohet administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi kështu që nuk po e votojmë këtë, por e lemë për ta trajtuar gjatë zbardhjes, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në “Kolegjin Zgjedhor Gjuqësor” pranë “Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë” brenda 5-ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet

Kalojmë në vendimin në tërësi të vendimit, edhe njëherë kolegë.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet

Vendimi nr. 18

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 18.04.2023*

18.04.2023
Ora 14:42

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për përdorimin e pajisjes elektronike të indentifikimit të zgjedhësve, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

PJESËMARRJA:

- **KQZ:**
 - **Komisioni Rregullator:**

Ilirjana NANO	Kryetare
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtare
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar
 - **Stafi i KQZ-së:** **Y. Merkaj**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **OJQ:** **KRIIK**

Znj. I. Nano: Pika 2, e rendit të ditës është projektvendimi “Për përdorimin e pajisjes së indentifikimit elektronik të votuesve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit, neni 20 i Kodit Zgjedhor parashikon në kompetencë të Komisionit Rregullator për shqyrtimin dhe miratimin e akteve me karakter normativ, përgatitur nga stafi i KQZ-së ose nga anëtarët e tijë për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, të domosdoshme për të

1

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 18.04.2023*

siguruar përdorimin e ligjshëm të rregullt, transparent, efikasë dhe të qëndrueshëm të tyre. Referuar nenit 14, pika 2, të Kodit Zgjedhor Nënëkomisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është përgjegjës për përcaktimin e zbatueshmërisë që drejton punën për zbatimin e projektit të indentifikimit elektronik të votuesve. Ai bashkëushton me të drejta të barabarta me komisionerin, kompetencat për përzgjedhjen e monitorimit dhe zbatimit të teknologjisë për indentifikimin elektronik të zgjedhësve. Gjithashtu referuar nenit 22, pika 4, e Kodit Zgjedhor, sistemet apo pajisjet e teknologjisë e informacionit që KQZ-ja vendos të përdor në zgjedhje duhet të shënojë në rradhë të parë indentifikimin elektronik të votuesve dhe verifikimin pas zgjedhor të tyre. Për sa më lartë në këtë relacion Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve brenda kompetencave të tyre i paraqesin Komisionit Rregullator, që procesi i indentifikimit elektronik të zgjedhësve për zgjedhjet e organit qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të indentifikimit që janë përdorur dhe në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, në të gjitha pikat e votimit të Republikës së Shqipërisë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtimin e miratimit, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj, si dhe akti që sapo miratuam edhe ky akt janë në serinë e akteve që janë në kompetencë të Komisionit Rregullator për të vendosur përdorimin e pajisjeve të teknologjisë në zgjedhje. Kemi rastin e PEVN-së që e kemi miratuar, pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit, rastin e kamerave në vendet e numërimit të votave. Rastin e pajisjes elektronike të indentifikimit të zgjedhësve. Të cilat miratohen rast pas rasti për çdo zgjedhje, pra nuk janë aktë me karakter gjeneralist. Përtej këtyre më tej miratohen edhe rregullat për përdorimin e këtyre lloj pajisjeve. Atëherë, kalojmë në shqyrtimin në parim të

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 18.04.2023**

projektvendimit. Kemi diçka kolegë? Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Shqyrtimi tashmë pikë për pikë. Atëherë ky është një projektakt që ka ardhur me propozim të Komisionerit Shtetëror dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si personi përgjegjës për implementimin e teknologjisë për sa i përket indentifikimit elektronik të zgjedhësve. Pika e parë, Komisioni Rregullator vendosi: Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Procesi i indentifikimit elektronik të zgjedhësve të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të indentifikimit “PEI” në të gjithë qendrat e votimit. Kemi diçka kolegë, zoti Çaka?

Z. D. Çaka: Faleminderit zonja kryetare, atëherë vlerësoj se në draft-in e propozuar nga administrata nga Komisioneri thuhet që në zgjedhjet për organet qeverisjes vendore të datës 14 maj procesi i indentifikimit elektronik të zgjedhësve të kryhet nëpërmjet pajisjes. Mendoj që ashtu si dhe kodi zgjedhor ka përcaktuar që duhet të ketë një proces indentifikimi të zgjedhjeve dhe jo elektronik të zgjedhjeve. Pastaj mënyra si do të kryhet ky proces indentifikimi të zgjedhjeve përcaktohet nga ky akt nëpërmjet kësaj pajisjeje. Pra propozoj që të jetë ky formulim i kësaj pike. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj, procesi i indentifikimit të zgjedhësve të kryhet nëpërmjet pajisjes elektronike të indentifikimit “PEI” në të gjitha qendrat e votimit.

***Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI***



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 18.04.2023**

Znj. I. Nano: Dakord, kalojmë në votimin e pikës 1, sipas propozimit të zotit Çaka.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet

Pika 2, ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet

Do të duhet të shtojmë, ngarkohet administrata e KQZ-së. Ka diçka nga administrata që doni ta shtroni për diskutim?

Znj. M. Koja: (Pa mikrofon, nuk dëgjohet)

Znj. I. Nano: Për përdorimin e pajisjes së indentifikimit elektronik të votuesve? Pajisja është e tillë, "PEI", elektronike e indentifikimit, vetëm ajo. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në "Kolegjin Gjyqësor" pranë "Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë" brenda 5-ditëve nga shpallja e tij.


Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

**Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 18.04.2023*

Do të duhet të shtojmë dhe atë që kemi thënë, kush ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi. Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit. Edhe njëherë kolegë ju lutem dakortësin tuaj për projektvendimin në tërësi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Duke qenë se nuk kemi çështje tjetër në rendin ditës apo jashtë rendit të ditës për të trajtuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur, faleminderit.

Vendimi nr. 19

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

